



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

Nr. 648 prot

Tiranë, më 16/08 2024

**URDHËR**

Nr. 250 prot, datë 16/08/2024

**PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESJES  
SHOQËRORE**

Në mbështetje të Ligjit nr 121/20216 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, neni 23, VKM nr. 518 dt 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për pëfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, urdhërit nr. 278 dt 25.07.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e nivelit të kuotave ushqimore”, si edhe Udhëzimit të MSHMS nr 662 prot., datë 06.12.2022 për “Një ndryshim në udhëzimin nr. 689 dt 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”

**URDHËROJ:**

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore për klientët që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror është:
  - Për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve – 430 lekë
  - Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 0-3 vjeç – 400 lekë
  - Për fëmijët e grup moshës 4-5 vjeç – 400 lekë
  - Për fëmijët e grup moshës 6-12 vjeç – 490 lekë
  - Për fëmijët e grup moshës 13-15 vjeç – 600 lekë
  - Për fëmijët e grup moshës 16-18 vjeç – 600 lekë
  - Për përfituesit mbi moshën 18 vjeç – 610 lekë
  - Për përfituesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës 7-11 vjeç – 510 lekë
  - Për përfituesit e vendosur në qendrat e zhvillimit të moshës mbi 11 vjeç – 610 lekë
2. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në qendra ditore publike të përkujdesit shoqëror është:
  - Në qendrat ditore polivalente- 310 lekë
  - Në qendrat ditore të zhvillimit- 350 lekë
  - Në shtëpitë ditore të fëmijës – 350 lekë



REPUBLICA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

3. Niveli i kuotës financiare të përballimit për shpenzimet ditore ushqimore për guzhinjerët dhe ndihmës guzhinjerët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reme Xholi

